




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**



**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.08.2023  
Ref. KM-295/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Temper 36 SL** i prodhuesit “**Profarm S.A**”, Greqi nga përfaqësuesi i saj “**EcoTech -Pest Control**” SH.P.K, Suharekë.

2. **LLOJI I PRODUKTIT:** Herbicid

3. **PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Glyphosate.....360g/l

**4. PËRDORIMI:**

**Temper 36 SL** është herbicid me veprim total mbi masën e gjelbër bimore. Lufton barërat e këqija njëvjeçare graminore dhe gjethegjera: Doza 1-2 L/ha ose 2% kur bimët janë në fazën e mbirjes deri në 10cm lartësi dhe 2-4L/ha ose 2% kur bimët janë në zhvillim. Për luftimin e barojave graminore shumëvjeçare: kundër *Cynodon dactylon*, *Imperta cilindrika*, *Panicium maximum*, *Paspalum spp* etj, trajtimi kryhet në fazën e rritjes deri në 8L/ha, 6L/ha kur masa bimore rritet. Për luftimin e barërave të këqija gjethegjera shumëvjeçare: doza 6L/ha ose 3 dhe te *Comvolvulus spp* deri 12 L/ha. Për luftimin e shkurreve dhe drurëve shumëvjeçare: së pari bëhet prerja e degëve duke shkaktuar plagë në kurorë e drurëve dhe trajtohet doza 7% pas 15 minutave, dhe kur gjatësia e bimëve arrin deri në 20cm

## 5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

100ml, 250ml, 1L, 5L, 10L, 25L.

## 6. VËREJTJE:

Kontakti me lëkurën: lani tërësisht zonën e prekur me sapun. Hiqni rrobat e ndotura dhe lani pjesët e prekura të trupit tërësisht me sapun dhe ujë. Kontakti me sy: Lani tërësisht zonën e prekur, nëse shqetësimi vazhdon, kërkoni këshilla mjekësore. Shpëlajeni menjëherë me ujë të bollshëm për të paktën 10 minuta në orë. Në rast të gëlltitjes: Mos i jepni asgjë viktimës nëse është pa ndjenja. Mos shkaktoni të vjella. Kërkoni këshilla mjekësore. Në rast inhalimi: Preparati ka paqëndrueshmëri të ulët. Transportoni viktimën nga zona e ekspozimit, mbajeni atë të ngrohtë dhe të rehatshëm. Ky produkt është i ekspozuar ndaj zjarrit, gjatë një zjarri mund të prodhohen gazra toksikë si monoksidi i karbonit dhe dioksidi, si dhe pentoksidi i fosforit dhe oksidet e azotit. Mos thithni tymrat dhe tymrat që mund të prodhohen. Vishni pajisje të përshtatshme mbrojtëse. Produkti klasifikohet si i dëmshëm për mjedisin. Mos e derdhni produktin në kanalizime, ujëra sipërfaqësor, rezervuarë nëntokësorë, kullues, ujëra të zeza dhe në çdo burim uji. Nëse futet në kanal, njoftoni menjëherë autoritetet përkatëse.

## 7. KARENCA:

Nuk ka.

## 8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.



Faton Peci

Ministër